Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals

**Prishtine, data: 18.05.2021**

**KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE -** Ne baze të Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, në lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 2461 dt. 10.09.2012 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Shaqir Likaj** pronar i kompanisë "Vëllezërit Likaj" sh.p.k me adrese Prianë, Prizren, merr këtë vendim :

DALJE
NR. PROT 2033
DD.MM.YYYY 18.05.2021
PRISHTINË/A

## AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtresave **Shaqir Likaj** pronar i kompanisë "Vëllezërit Likaj" sh.p.k me adrese Prianë, Prizren, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

## Arsyetim

Ndaj **Shaqir Likaj** pronar i kompanisë "Vëllezërit Likaj" sh.p.k me adrese Prianë, Prizren, KPMM ka leshuar aktin administartiv me nr. 2461 dt. 10.09.2012

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt. 10.09.2012 dhe me dt.24.03.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .

Ramiz Krasniqi
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

**Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova**
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals

Prishtinë, 21.08.2012

Në pajtim me nenin 79 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerre këtë:

## AKTVENDIM

Ndaj Shaqir Likaj pronar i kompanisë "Vëllezërit Likaj" nr. i regjistrimit të biznesit i mungon nr. i telefonit 044/ 263 498, me adresë Fusha e Krajkut – Piranë, Komuna Prizren.

1. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoba admnistrative për zhvillimin e aktivitetit ilegal mineral pa Licence të Shfrytëzimit në shumë prej **5,000.00€**

### Arsyetim

Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 17.10.2011, kompania "Vëllezërit Likaj" është hasur duke operuar ilegalisht në shfrytëzimin e resurseve minerale. Lokacioni i shfrytezimit gjendet në fushën e Krajkut – Piranë, Komuna Prizren. Inspektoret e Minierave kanë konstauar se kompania juaj është duke ushtruar aktvitet të paligjshëm pa u paijsur me Licence te Shfrytëzimit.
Makineria e angazhuar me të cilën kompania juaj zhvillonte aktivitetin e shfrytezimit të mineraleve të rërës dhe zhavorrit përbëhet prej: Eskavator Liebherr 534 me numer serik 321515676.
Kompania është udhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerje të aktivitetit ilegale të lëshuar nga Inspektoret në datën e inspektimit që menjeher të ndërprej aktivitetin e paligjshëm.
Inspektoret e Minierave kane konstatuar se kompania juaj me pronar Shaqir Likaj aktivitetin e operimeve ilegale e bënte në lokacionin me keto kordinata: Y= 7472568, 7472543, 7472543, 7472661; X= 4682210, 4682234, 4682225, 4682252; Z= 304, 304, 304, 304, për të cilat kordinata nuk posedoni Licenc të Shfrytëzimit.

Afati për kryerjen e pagesaës së gjobës administrative është 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pagesa e faturës bëhet në Bankën Qendrore të Kosovës në këtë xhirollogari 1000430070005950.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i KPMM

INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS
NR PROT 2461
10/09/2012
PRISHTINË/A

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë
**Tel:** +381 (38) 240 252
**Fax:** +381 (38) 245 844
**E-mail:** ICMM@kosovo-mining.org
**Web:** www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa duke ju drejtuar Komisionit për Ankesa pranë KPMM-së në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Ankesa kundër këtij aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit sipas nenit 128 par.(a) të Ligjit për Procedurën Administrative.

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së
Departamentit të Financave të KPMM-së
Palës

Selvete Grajqevci-Pllana
U.D e Drejtorit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale